

Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

- a) familjet në nevojë;
- b) jetimët të cilët nuk janë në institucione;
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
- ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- d) viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

1. Shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të personave dhe të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtare.
2. Azilkërkuessit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilantit.
3. Shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave.

Blok ndihma 6%:

Ndihma ekonomike shpërndahet në formën e “blok ndihmës” që nënkupton ndihmën, krejtësisht në para, e cila jepet nga shteti për qëllim të caktuar. Masa e ndihmës ekonomike mujore përcaktohet nga Këshilli i Bashkisë i cili merr në konsideratë:

1. Fondin e bllok-ndihmës
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me kriteret e familjeve që nuk kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë ekonomike.
3. Me fondin e bllok-ndihmës 6% trajtohen familjet që nuk kanë dalë përfituese nga sistemi i pikëzimit.

Përfituesit e kompensimit të energjisë:

Familjet përfituese të ndihmës ekonomike, të cilat kanë kontratë në emër të kryefamiljarit, paraqesin faturën e muajit të fundit të paguar dhe fotokopjen e librezës së energjisë, deri në datën 25 të çdo muaji.

Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike:

Ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor, në lekë, ose përfitimi mujor, në natyrë për kategoritë e përcaktuara në ligj. Ndihma ekonomike është e kufizuar në një afat kohor prej 5

vjetësh. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike nuk aplikohet, për:

a) familjet, anëtarët e së cilës janë mbi moshë pune;

b) familjet me kryefamiljare gra, me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë.